

Në bazë të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 2 dhe paragrafi 6 të Ligjit për shërbimin gjyqësor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 43/14) nenit 23 dhe nenit 24 të Ligjit për marrëdhënie pune (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.167/15, 27/16, 120/18 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.110/19, 267/20 dhe 151/21), nenit 26 dhe nenit 60 të Rregullores për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë dhe pëlqimit nga Ministria e financave nr. 18-1769/2 të datës 21.02.2021

GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
publikon
SHALLJE PUBLIKE NUMËR 1/2022
për punësim të 2 (dy) personave për kohë të caktuar deri më 31.12.2022

1.Këshilltar-zëdhënës - 1 (një) realizues

Kushtet e posaçme:

Të arritura 300 kredi të fituara sipas ECTS -së ose shkallë të kryer VII/1, fakultetin juridik ose fakultetin e gazetarisë dhe së paku 3 vjet përvojë pune në profesion.

Kompetencat e posaçme të punës: Njohje aktive të një prej tri gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin Evropian (anglisht, frëngjisht dhe gjermanisht), njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe kompetenca të tjera të posaçme të punës të përcaktuara në aktin për sistematizim të vendeve të punës për vendin përkatës të punës

Orari javor i punës është 40 orë;

Orari i punës ditore 8 orë, nga ora 07,30 deri në orën 15,30;

Rroga neto në para në vlerë: 28.639,00 denarë

2. Mirëmbajtës të higjienës - 1 (një) realizues

Kushtet e posaçme:

Arsimim të mesëm ose fillor të kryer, me ose pa përvojë pune.

Orari javor i punës është 40 orë;

Orari i punës ditore 8 orë, nga ora 13,00 deri në orën 21,00;

Rroga neto në para në vlerë: 15.274,00 denarë

Krahas kushteve të theksuara të posaçme, të parapara me Rregulloren për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë, kandidatët duhet t'i përmbushin edhe kushtet e përgjithshme të parapara në nenin 21 paragrafi 1 të Ligjit për shërbimin gjyqësor:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- në mënyrë aktive të përdorë gjuhën maqedonase,
- të jetë i moshës madhore,
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës, dhe

-Certifikatë për arsimin e kryer përkatës

-Dëshmi për përvojë pune

-Certifikatë të shtetësisë

-Certifikatë të mjekut për gjendjen e përgjithshme shëndetësore

-Certifikatë ose vërtetim me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës

Kandidatët të cilët paraqiten për vendin e punës nën nr. Rendor 1- Këshilltar-zëdhënës, duhet që lutjes t'i bashkëngjisin edhe:

-Diplomë, certifikatë ose vërtetim si dëshmi për njohjen e një prej tri gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin Evropian (anglisht, frëngjisht dhe gjermanisht)

-Diplomë, certifikatë ose vërtetim si dëshmi për njohje të programeve kompjuterike për punë në zyrë

Lutja, krahas dëshmimeve, është e obligueshme të përmbajë: emër dhe mbiemër të kandidatit të mbështetura me dëshmi për identifikim personal, vendbanim, gjegjësisht vendqëndrim të kandidatit, e – mail adresë ose telefon për kontakt.

Afati për parashtrimin e lutjeve është 5 (pesë) ditë nga dita e publikimit të shpalljes në gazetën ditore (duke mos llogaritur ditën e vet publikimit).

Kushtet e theksuara në shpalljen, kandidatët duhet t'i përmbushin në momentin e paraqitjes.

Vërejtje: Kandidati i cili do të parashtrijë të dhëna të rrejshme do të diskualifikohet nga procedura e mëtejshme

Lutjen me dëshmitë, kandidatët obligohen që t'i dorëzojnë drejtpërdrejtë në sportelin për pranimit të dokumenteve në Gjykatë, gjatë orarit të punës ose përmes adresës postare:

GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Bul. Kërste Misirkov nr.8 Shkup
(me shenjë për Shpallje publike numër - 1/22)

- me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kandidatët e interesuar, obligohen që të parashetrojnë lutje të plotësuar për punësim të nëpunësit gjyqësor me dëshmitë për plotësim të kushteve të përgjithshme dhe të posaçme për vendin e punës në të cilin paraqiten në origjinal ose kopje të vërtetuara në Noter:

Lutjet e dorëzuara pas afatit, jo të plota, të parregulluara dhe të pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Zgjedhja e kandidatëve do të realizohet në afatin e caktuar në nenin 23 të Ligjit për marrëdhënie pune.